

LIGJ
Nr.7687, datë 16.3.1993

PËR STATISTIKËN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryeore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Shërbimi statistikor ka për objekt grumbullimin, përpunimin, publikimin dhe ruajtjen (arkivimin) e të dhënave statistikore.

Neni 2

Shërbimi statistikor kryhet nga Instituti i Statistikës, drejtoritë e statistikës në rrethe, drejtoritë (sektorët) e statistikës të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, zyrat e gjendjes civile si dhe personat juridikë a fizikë.

Neni 3

Ndërmarrjet, institucionet, zyrat e gjendjes civile dhe persona të tjerë juridikë a fizikë detyrohen të dërgojnë të dhënat statistikore të kërkuara në përputhje me programin kombëtar statistikor të miratuar në shkallë vendi dhe të përdorin kriteret e evidencimit e ato metodologjike, emërtesat e klasifikimet e miratuara nga Instituti i Statistikës. Degët e tatimeve dhe të financës në rrethe detyrohen të bëjnë të njohur në Institutin e Statistikave krijimin dhe ndryshimet e ndodhura për ndërmarrjet, institucionet dhe personat juridikë a fizikë.

Neni 4

Të gjitha të dhënat statistikore individuale të grumbulluara në organet e statistikës nga ndërmarrjet, institucionet dhe personat juridikë a fizikë kanë karakter konfidencial (sekret statistikor) dhe bëhen të njohura e përdoren vetëm për qëllime statistikore në formë të grupuar. Ato në asnjë rast nuk mund të përdoren për qëllime të kontrollit fiskal, të represionit ekonomik apo për hetime gjyqësore. Punonjësit që ngarkohen për plotësimin e regjistrave e skedarëve, përpunimin dhe grupimin e këtyre të dhënave ruajnë sekretin e inforimitit e publikimit nominal të tyre.

Neni 5

Të dhënat e grumbulluara nga vërtetimet dhe regjistrimet statistikore, përveç atyre që publikohen, jepen vetëm për qëllime kërkimore e studimore sipas kërkesës me shkrim të përdoruesit dhe me autorizim të drejtorit të Institutit të Statistikës. Të dhënat që njofton e publikon Instituti i Statistikës përfaqësojnë të dhënat zyrtare të vendit.

II. INSTITUTI I STATISTIKËS

Neni 6

Instituti i Statistikës është institucion qendror në varësi të Këshillit të Ministrave, i cili miraton numrin e punonjësve të këtij instituti, të drejtorive (sektorëve) të statistikës në ministri e institucione qendrore si dhe të drejtorive të statistikës në rrethe. Këshilli i Ministrave miraton gjithashtu rregulloren për të drejtat dhe detyrat e Institutit të Statistikës, të drejtorive (sektorëve) të statistikës në ministri e institucione të tjera qendrore dhe drejtorive të statistikës në rrethe.

Neni 7

Instituti i Statistikës drejtohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave. Në varësi të tij të drejtpërdrejtë krijohen drejtoritë e statistikës në rrethe. Drejtori i Institutit të Statistikës emëron e shkarkon punonjësit e këtij instituti dhe të drejtorive të statistikës në rrethe. Me propozim të titullarit përkatës ai miraton drejtorët ose përgjegjësat dhe punonjësit e statistikës në ministri a institucion tjetër qendror.

Neni 8

Në Institutin e Statistikës krijohet këshilli i statistikës si organ konsultativ, që kryesohet nga drejtori i Institutit të Statistikës, i cili miraton edhe përbërjen e tij.

Neni 9

Në përputhje me programin statistikor Instituti i Statistikës grumbullon, kryen përpunimin unik të të dhënave dhe nxjerr rezultate statistikore, të cilat i analizon dhe boton. Ndjek zbatimin e kriterëve metodologjike në përputhje me rekomandimet që i përgjigjen standarteve ndërkombëtare. Organizon e drejton kryerjen e regjistrimeve të përgjithshme me miratim të Këshillit të Ministrave. Me pëlqimin e Institutit të Statistikës, sipas kërkesës së titullarëve të dikastereve, institucioneve qendrore, rretheve, bashkive dhe komunave si dhe partive politike e të organizatave të ndryshme, këto kryejnë vrojtime me zgjedhje.

III. MASA ADMINISTRATIVE DHE NDËSHKIMORE

Neni 10

Mospërgjegjësit në afat dhe përgjegjësit e pasakta për informacionin e kërkuar statistikor sipas miratimit të Institutit të Statistikës, kur ato nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundravajtje administrative dhe dënohen me gjobë. Personat juridikë a fizikë, titullarët e institucioneve e të zyrave dhe atyre të statistikës që i shkelin këto rregulla për herë të parë dënohen me gjobë deri në 2000 lekë. Në rast përsëritjeje brenda tre vjetëve, shuma e gjobës jepet nga 2000 deri në 10000 lekë për çdo shkelje.

Personat që kanë pranuar të japin përgjegjësi dhe që refuzojnë ta japin në afat ose që japin përgjegjësi të pasakta për informacionin e kërkuar statistikor nga Instituti i Statistikës për të dhënat që kanë lidhje me jetën e tyre personale e familjare, dënohen me gjobë nga 500 deri në 1500 lekë dhe në rast përsëritjeje nga 1500 deri 5000 lekë.

Punonjësit e shërbimit statistikor, që nuk ruajnë sekretin dhe karakterin konfidencial siç përcaktohet në nenin 4, kur nuk formojnë vepër penale, dënohen me gjobë në masën 2000 lekë.

Neni 11

Dënimet me gjobë jepen nga përgjegjësat e Institutit të Statistikës nga drejtorët ose përgjegjësit e sektorit të statistikës të ministrive e institucioneve të tjera qendrore. Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të tij, te drejtori i Institutit të Statistikës, akti i të cilit është i formës së prerë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Nenet 10, 11, 12, 13 dhe 14 të ligjit nr.6802, datë 29.6.1983 "Për hartimin, miratimin e zbatimin e planit unik e të përgjithshëm të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës popullore të Republikës së Shqipërisë", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.499, datë 26.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha